

LEKSION III-IV

METODA TRADICIONALE E BASHKËKOHORE NË MËSIMIN E GJUHËS SHQIPE

CËSHTJET:

1. Metodatat e mësimdhënies me qendër mësuesin
 - a. Shpjegimi
 - b. Biseda
 - c. Ligjëratat
 - d. Demonstrimi
 - e. Teknika e të pyeturit
2. Metodatat e mësimdhënies me qendër nxënësin

Metodatat e mësimdhënies me qendër mësuesin

Roli i këtyre metodave qëndron në pajisjen e nxënësit me njohuri që do të sigurojnë bazën e të menduarit të mëtëjshëm. Ky është grupi tradicional i metodave të mësimdhënies dhe përfshin: **shpjegimin, bisedën, ligjëratën, bisedën, demonstrimin dhe të pyeturit**. Le t'i shikojmë me radhë.

Shpjegimi:

Kjo metodë, e cila ndryshe quhet edhe “mësimdhënie e drejtpërdrejtë”, është teknika që përfshin një pikësynim arsimor, paraqet një mundësi zgjedhjeje aktiviteti nga nxënësit, ndihmon mësimdhënien në grupe të mëdha dhe përqendrohet në pyetje faktike dhe praktike të kontrolluara në klasë.

Përpara se të vendosim të përdorim këtë metodë, duhet të jemi të sigurt nëse rezultatet tona mësimore u përshtaten meritave të mëposhtme të mësimdhënies së drejtpërdrejtë ku mësuesi siguron:

- Shpjegim mësimi për të gjithë klasën.
- Kontrollon përqendrimin e vëmendjes.
- Shfrytëzon maksimumin e kohës në dispozicion.
- Vlerëson shpejt reagimin e klasës nëse e kanë kuptuar.
- Lejon mësuesin t'u përgjigjet pyetjeve të nxënësve të cilat mund të kenë vetëm një herë interes për klasën.
- I jep mundësi mësuesit të përdorë reagimet e nxënësve që të përmirësojë një mësim apo aktivitet.
- Kërkon më pas kohë për përgatitje sesa shumë strategji të tjera mësimore
- Thekson aftësitë e mësuesve që të njëjtën sasi kohe të merren me detyrën,
- U jep të gjithë nxënësve të njëjtën sasi kohe të merren me detyrën

Të metat e metodës së shpjegimit:

- lejon shumë pak individualitet të aktivitetit të mësimit ,

- kërkon që mësuesi të drejtojë mësimin në një nivel mesatar aftësie,
- mbështet aftësitë profesionale të mësuesit,
- kërkon përdorimin në maksimum për efekshmërinë e materialeve audiovizive,
- i lejon mësuesit të përdorin mësimdhënien e drejtpërdrejtë si justifikim për mungesën e përgatitjes.

-

Përdorimi i metodës së drejtpëdrejtë:

Në mësimdhënien e drejtpëdrejtë mësuesi është nën kontroll, sepse kjo metodë tregon, nxjerr në pah, modelon, demonstron dhe mëson shprehinë ose konceptin që duhet mësuar.

Kjo mësimdhënie përmban:

1. Njohjen

Pasi të ketë fituar vëmendjen në klasë mësuesi u tregon nxënësve se për çfarë do të flitet në mësim. Në këtë kohë mësuesi detajon se çfarë pret nga mësimi.

2. Demonstrimin

Mësuesi sjell një shembull dhe sqaron vlerën dhe qëllimin e konceptit të mësimi

3. Prezantimin

Mësuesi paraqet skenarin mësimor në vazhdimësi duke lëvizur nga e thjeshta tek e vështira. Shpesh do të mbështetet në mësimet e kaluara ose në koncepte dhe përvoja të njohura nga nxënësit.

4. Praktikën e udhëzuar

Klasa e praktikon konceptin nëpërmjet teknikave pyetëse, punës në tabelë dhe në grup. Klasa jep përgjigje sipas komandës së mësuesit.

5. Praktikën e pavarur

Klasa lihet të punëjë individualisht apo në grup, ndërsa mësuesi vëzhgon me kujdes përparimin e saj.

Ecuria metodike

Faza 1. Përgatitja për shpjegim

Në këtë fazë mësuesi kryen këto veprime

- Njeh nivelin e nxënësve dhe nevojat e tyre për temën që do të shpjegohet
- Planifikon me kujdes çfarë do të shpjegojë dhe si do ta kryejë shpjegimin
- Përcakton objektivat që do të arrijë nëpërmjet shpjegimit
- Përcakton hapat që do të ndjekë për të shpjeguar konceptet, idetë.
- Gjen shembuj për të konkretizuar idetë, tezat, dukuritë
- Përzgjedh mjetet që do të përdorë
- Orienton paraprakisht klasën për shpjegimin

Faza 2. Kryerja e shpjegimit

- **Teknika hyrëse.** Për të nisur shpjegimin mësuesi mund të përdorë teknika dhe mjete të ndryshme
- **Teknika e stuhisë së mendimeve.** Në dërrasën e zezë shkruhet një fjalë, një koncept, një ide ose një temë. Kjo metodë e ndihmon mësuesin të kuptojë çfarë dinë e çfarë nuk dinë nxënësit.
- **Harta e të pyeturit.** Kjo teknikë kërkon të formulohet një tërësi pyetjesh rreth një problemi, koncepti a teme. Veçohet pyetja që përbën strumbullarin e asaj që do të bëhet objekt i shpjegimit.

- Mjetet mësimore, si grafikë, fotot skica, video mund të përdoren si pikënisje për shpjegimin.

- **Faza III Zbatimi i shpjegimit**

Në këtë fazë u drejtohen pyetje nxënësve për të njohur shkallën e të kuptuarit dhe zhvillohen veprimtari të ndryshme që nxënësit të zbatojnë atë që kanë kuptuar nëpërmjet shpjegimit.

Kjo metodë mund të përdoret në këto tema:

-“Shkrimi i letrave, kartolinave”

- “Fjalorët” etj.

Biseda

Është një metodat më të hershme në procesin e mësimdhënies. Kjo metodë organizohet mbi bazën e dialogut mësues-nxënës. Ajo shërben:

- për të paraqitur dijet e reja
- për të kontrolluar të dhënat që kanë nxjerrë nxënësit nga vrojtimet e sendeve dhe dukurive të ndryshme.

Metoda e bisedës edhe në lëndën e gjuhës ka një vijë metodike të thjeshtë. Mësuesi përcakton objektin e bisedës, studion çfarë dinë nxënësit rreth objektit për të cilin bisedohet, bën pyetje, dëgjon përgjigjet dhe vërejtjet që nxënësit i bëjnë aty për aty njëri-tjetrit. Në fund mësuesi bën plotësimet e nevojshme. Kur përdoret metoda problemore nxënësit nxiten të mendojnë dhe të gjykojnë, të bëjnë ndonjë krahasim apo klasifikim, përpiqen që të bëjnë ndonjë kërkim, krahasim apo klasifikim, përgjithësime me qëllim që biseda të dalë sa më bindëse. Një variant është biseda e lirë. Kjo organizohet kur nxënësit kanë njohuri të mjaftueshme për të nxjerrë përfundimet e nevojshme për një dukuri të caktuar për mësimet përgjithësuese. Pyetja i drejtohet gjithë klasës dhe pasi nxënësve u lihet e nevojshme për të menduar, caktohet njëri prej tyre për t’u përgjigjur. Mësuesi duhet të ketë durim për të dëgjuar deri në fund fjalinë dhe duhet që të aktivizojë tërë klasën, jo vetë ato që ngrenë dorë. Metoda e bisedës shërben edhe për përforcime dijeve. Ajo përdoret për të shkëmbyer informacion, për të shpjeguar koncepte të reja, për të dhënë modele, për të korrigjuar, për të krijuar marrëdhënie shoqërore mes pjesëmarrësve.

Eciria metodike:

Faza I. Prapërgatitja

Përcaktohet qëllimi i bisedës, plani i saj, zgjidhen mjetet që do të përdoren

Faza II. Zhvillimi i bisedës

- Paraqitet qëllimi, objektivat dhe rolet e bashkëbiseduesve.
- Paraqitet informacioni nga mësuesi.
- Drejtohen pyetje nga mësuesi.
- Jepen përgjigjet nga nxënësit.
- Bëhen pyetje nga nxënësit.
- Përgjigjen nxënës të tjerë ose mësuesi.

Me këtë metodë nxitet tek nxënësit pavarësia, nisma krijohen marrëdhënie të ndërsjellta ndërmjet mësuesve dhe nxënësve.

Japim një shembull. Nxënësit duhet të shkruajnë një fjali: *Punëtorët i përfunduan para afatit shtëpitë e reja*. Për një fjalë të caktuar nxënësit ndeshin në pengesë, ka një dyshim. Para tij lind pyetja, si duhet shkruar fjala *shtëpitë*, me –ë në fund apo pa –ë.

Këtë pyetje ia bën vetes. Mësuesi e drejton bisedën aty ku duhet. Për ta shkruar drejt këtë fjalë nxënësi duhet të kujtojë njohuritë e fituara më parë dhe të vendosë lidhjen e duhur me to. Prandaj ai kërkon përgjigjen e saktë, duke shfrytëzuar hallkat e ndryshme që gjenden ndërmjet pyetjes e përgjigjes. Afërsisht ai arsyeton kështu: *shtëpitë* është emër, gjinia femërore, rasa kallëzore; theksi i fjalës bie tek zanorja –i, shqiptimi i fjalës tingëllon i tillë: *shtëpitë*. Pas kësaj ai bindet përfundimisht se kjo fjalë duhet shkruar me –ë. Po nëpërmjet bisedës nxënësi mund të bëjë analogji me fjalë të tjera të cilat, janë rast i njëjtë me fjalën *shtëpitë*, si: *çatitë, qershitë, rrufetë* etj.

Ligjërata

Është një metodë me në qendër mësuesin që përdoret me sukses edhe për mësimdhënien e gjuhës shqipe në shkollë. Përdorimi i kësaj metode konsiston në analizën e fakteve, lidhjen e tyre, argumentin e përfundimeve dhe të përgjithësimeve nga vetë mësuesi. Mësuesi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë, gjatë analizave gjuhësore apo letrare konkretizon konceptet bazë nëpërmjet veprave të lexuara. Ndërprerjet e ligjëratës duhet të bëhen me kujdes, pa cënuar logjikën dhe unitetin e mendimeve që paraqiten në të.

Organizimi i një ligjërate problemore që tërheq vëmendjen dhe, për rrjedhojë, interesin shkencor të nxënësve, mënjanon qëndrimin pasiv të nxënësve. Është pak e përdorur në ciklin fillor.

Demonstrimi

Në themel të kësaj metode qëndron shoqërimi i fjalës së mësuesit me mjete që konkretizojnë sendet dhe dukuritë e ndryshme që punohen me nxënësit. Demonstrimi është një metodë e pavarur. Sot kërkohet që nxënësi të dijë të mbajë qëndrim ndaj një krijim letrar apo detyre krijuese në lëndën e gjuhës apo në jetën e përditshme, kur duhet të përceptojë, të mendojë dhe të gjykojë për të nxjerrë ndonjë përfundim për çdo dukuri apo studim. Në fund të demonstrimit, mësuesi, në formë diskutimi apo bisede, kontrollon sa u kuptuan dijet që u dhanë. Edhe gjatë mësimdhënies së lëndës së gjuhës, kjo metodë bashkëkohore zë vend të rëndësishëm nëpërmjet demonstrimeve me aparate moderne: magnetofonët, video. Demonstrimi i filmave mësimorë dhe artistikë, i dokumentarëve për njerëz të shquar të artit, kulturës, të dijes, ndihmon për të zgjuar interesin për lëndën e gjuhës dhe një përceptim të qartë të saj nga nxënësit.. Kjo metodë, shkurton kohën, nxit diskutimin krijues, shton veprimtarinë dhe pjesëmarrjen aktive të nxënësve në mësim. Demonstrimi është një nga metodat më të vjetra të mësimdhënies.

Ecuria metodike

Faza I. Parapërgatitja për demonstrim

- Bëhet një analizë përgjithësuese e aftësive që i shërbejnë demonstrimit dhe atyre që zotërojnë nxënësit.
- Zgjidhet çështja e përshtatshme për demonstrim dhe përcaktohet lloji i demonstrimit.
- Demonstrimi përfshin paraqitjen pamore, gojore, lëvizore.
- Sigurohen mjetet e nevojshme për demonstrim që më përpara.

Faza II. Zhvillimi i demonstrimit

- Paraqitet qëllimi i demonstrimit
- Paraqitet roli i mësuesit dhe i nxënësit
- Paraqitet skema e demonstrimit
- Kryhet demonstrimi hap pas hapi nga mësuesi
- Nxënësve u jepet mundësia të marrin pjesë në demonstrim nën drejtimin e mësuesit që u drejton pyetje për të zhvilluar të kuptuarit.

Faza III. Vlerësimi i demonstrimit

- Në këtë fazë bëhen përfundimet dhe vlerësimet për demonstrim
- Vlerësimi duhet të përputhet me modelin mësimor
- Demonstrimi duhet t'i përshtatet karakteristikave psikomotore të nxënësve. Ai duhet të marrë parasysh nivelin e njohurive, aftësive psikofizike të nxënësve.
- Të bëjmë kujdes që çdo nxënës të ndjekë demonstrimin

Teknika e të pyeturit

Gjatë gjithë historisë së arsimit, teknika e të pyeturit në procesin e mësimdhënies ka qenë mënyra më e zakonshme e të pyeturit. Të pyeturit nënkupton teknikën që bazohet në përdorimin e pyetjeve për të marrë përgjigje nga nxënësit për një çështje të paraqitur. Kjo teknikë përdoret

- Për të zbuluar diçka që nuk njihet
- Për të zbuluar nëse dikush di diçka
- Për të zhvilluar aftësitë e të menduarit
- Për të motivuar aftësitë për të nxënë
- Për të theksuar çështjet kryesore
- Për të zbuluar interesat e nxënësve
- Për të bërë vlerësime

Llojet e pyetjeve

- a) pyetje që kontrollojnë kujtesën: përkufizime, vargje dhe pjesë përmendësh
- b) pyetje që vënë në provë aftësitë e nxënësve për të grupuar të dhëna: cilat janë klasat e fjalëve të ndryshme? Çfarë veprash ka shkruar X shkrimtar?
- c) Pyetje që synojnë të provojnë aftësinë e nxënësve për analizë: A është folja pjesë e ndryshueshme e ligjëratës?
- d) Pyetje që synojnë të kontrollojnë aftësinë e nxënësve për sintezë: A ka tipare të përbashkëta mes emrit dhe mbiemrit?
- e) Pyetje që synojnë të nxisin mendimin kritik të nxënësve: Si lakohet mbiemri i panyjshëm? (ai nuk lakohet)
- f) Pyetje që synojnë të nxisin gjendje emocionale të nxënësve: Ç'ndjenja provuat kur lexuat.....

Faza I – Planifikimi i pyetjeve

Pyetjet mund të planifikohen ose të bëhen në çast, por duke mbajtur parasysh:

- objektivat mësimore
- veçoritë e lëndës

- përvoja dhe nevojat e nxënësve
- sasia e pyetjeve
- koha nëdispozicion të të pyeturit.
-

Faza II- Drejtimi i pyetjeve

- Pyetjet i drejton mësuesi, por edhe nxënësve u lihet hapësirë për pyetje
- Pyetjet i drejtohen klasës, një grupi ose individëve
- Kur pyetja nuk dëgjohet ose nuk kuptohet, përsëritet edhe një herë.

Faza III. Trajtimi i përgjigjeve

- Dëgjimi me vëmendje të përgjigjeve të nxënësve
- Mësuesi duhet të presë me dashamirësi edhe përgjigjet e gabuara të nxënësve
- Për përgjigjet e gabuara mësuesi korrigjon me takt
- Përgjigjet e sakta shoqërohen me stimuj

II. METODAT E MËSIMDHËNIES ME QENDËR NXËNËSIN

Po të krahasojmë mësimdhënien me qendër mësuesin dhe mësimdhënien me qendër nxënësin do të kishim këto rezultate:

<u>Nga:</u> Mësimdhënia pasive	<u>Në:</u> Mësimdhënien me në qendër nxënësin
Mësuesi shpjegon	Mësuesi drejton, orienton, udhëzon
Nxënësi dëgjon	Nxënësi përfshihet, vepron
Mësuesi pyet	Mësuesi i vë nxënësit të bëjnë pyetje
Nxënësi përgjigjet kur e pyesin	Nxënësi bën pyetje dhe kërkon përgjigje
Mësuesi flet	Mësuesi, diskuton, bisedon, shkëmben ide
Nxënësi riprodhon	Nxënësi diskuton, argumenton, arsyeton
Mësuesi vlerëson	Mësuesi i përfshin nxënësit në vlerësim dhe vetëvlerësim
Mësuesi komandon	Mësuesi menaxhon, organizon

Metodat e mësimdhënies me qendër nxënësin janë:

Diskutimi mësimor

Kjo metodë ka në qendër nxënësin. Kjo metodë hyn në metodat e punës në grup dhe krijon në mësim një atmosferë të gjallë e të ngrohtë. Kjo metodë ka dy faza: puna përgatitore për diskutim dhe diskutimi për çështjet e caktuara.

Në fazën e parë mësuesi i orienton nxënësit ç'të mësojnë, ç'të vërtetojnë, çfarë shënimesht ë mbajnë. Kjo metodë përdoret sidomos në orët e përsëritjes.

Por ai ndihmon edhe në etapën e përfundimit të njohurive Diskutimi është metoda mësimore në të cilën nxënësit bisedojnë së bashku, marrin dhe japin informacion tek njëri-tjetri

Ecuria metodike

Faza I- Parapërgatitja

- Zgjidhet tema ose çështja për diskutim
- Përcaktohet objektivi i diskutimit
- Ndahen detyrat e pjesëmarrësve në diskutim

Faza II- Zhvillimi i diskutimit

- paraqitet përmbledhtas tema dhe plani i diskutimit
- Për të filluar diskutimin, mund të përdoret një bisedë hyrëse, film, regjistrime me magnetofon
- Vazhdohet me pyetje të spikatura
- Nëse bllokohet diskutimi është mirë të sqarohet diçka thjeshtë dhe shkurt
- Ftojini nxënësit në diskutim duke përdorur shprehje “Duket ide interesante, mund ta vazhdoni më tej mendimin?”

Faza III- Vlerësimi i diskutimit

- Përmbledhen pikat kryesore
- Renditen faktet e paraqitura
- Tregohet ç’është analizuar
- Arrihet mirëkuptimi
- Bëhet vlerësimi i punës

Konkursi mësimor

Është një nga metodat tradicionale që zhvillohet me sukses në orën e mësimit të gjuhës.

Ecuria metodike

- Mësuesi përgatit pyetjet që do t’i drejtojë klasës
 - Mësuesi paralajmëron konkursin për orën e ardhshme
 - Orienton nxënësit për pyetje që do t’i drejtojnë njëri-tjetrit.
 - Ndahet klasa në grupe në përshtaje me dijet e nxënësve
 - Përcaktohen rregullat dhe mënyra e drejtimi të pyetjeve (me gojë ose me shkrim) p.sh
 - a) Thoni shumësin e emrave të mëposhtëm: dukument (-e), artist (-ë), gjel (-a), doktor (-ë)
 - b) I drejtoni secilit grup nga një pyetje
 - c) I bëni njëri- tjetrit dy urime, dy ngushëllime, dy përshëndetje
- Në fund bëhet vlerësimi i konkursit

Puna me grupe

Kjo metodë mësimore e organizon mësimin mbi bazën e grupeve të nxënësve. Zakonisht, një grup përbëhet nga 5-6 nxënës. Gjatë punës me grupe, vendosja e bankave në klasë bëhet në përshtatje me grupet të cilat duhet të jenë të veçuara.

Strategjitë e punës në grupe synojnë:

- zhvillimin e mendimit kritik, krijues dhe të pavarur e bashkëveprues
- sjellin teknika të larmishme në orën e mësimit që bëjnë të mundur përvetësimin e mësimit
- kontribuojnë pozitivisht në procesin e të nxënësve

Të mësuarit përmes lojës

Loja me role është një metodë bisedore e shkurtër, e cila zhvillon tek nxënësit rrjedhshmërinë, nxit ndërveprimin në klasë duke i lënë më shumë hapësirë nismës dhe imagjinatës së nxënësve. Qëllimi i përdorimit të lojës me role në klasë është të stërvisë nxënësit të manipulojnë me natyrën e gjuhës. Shkalla e përdorimit të gjuhës ndryshon nga njëri nxënës tek tjetri.

Ecuria metodike

Hapi I- Parapërgatitja e lojës

- Nxënësit duhet të kuptojnë situatën e lojës, e cila duhet të paraqitet thjeshtë
- Përcaktohen rolet.
- Nxënësit që nuk marrin pjesë në role mund të vëzhgojnë

Hapi II- Luajtja e rolit

Roli luhet sipas një plani. Nxënësit veprojnë në lojën me role sikur të ishin në një situatë konkrete. Mësuesi nuk duhet ta ndërpresë.

Në fund komentohen rolet dhe bëhet vlerësimi i nxënësve.

Vrojtimi

Është një metodë që e vë nxënësin në rolin e vëzhguesit, kërkon të vrojtojë , të mbajë shënime, t'i përpunojnë dhe t'i publikojnë përfundimet.

ROLI I MËSUESIT NË MËSIMDHËNIEN ME QENDËR NXËNËSIN

Organizues i mësimit

Vlerësues

Udhëheqës i procesit

MËSUESI

Motivues

Partner në komunikim dhe ndërveprimin në klasë